



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:249565

Datë: 12.01.2021

Numri i dokumentit: 01419733

**Ac.nr.1994/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Kujtim Pasuli-kryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Makifete Saliuka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit H.H. nga Fshati ..., Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson av. E.Q. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), për shkak të kompensimit të pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimin në emër të pagave përcjellëse për në pension, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan, C.nr.961/2019, të datës 29.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.01.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), si e pabazuar, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C nr. 961/19, të datës 29.01.2020.

**A r s y e t i m**

Në aktgjykimin e goditur të Gjykatës të shkallës së parë nën I të dispozitivit, është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.H. nga Fshati ... Komuna e Gjilanit dhe obligohet e paditura Komuna e Gjilanit – DKA që paditësit H.H., t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar një pagë bazë, për 39 vite të përvojës së punës shumë prej 468.73 €, si dhe tri (3) paga mujore për përcjellje në pension në shumë prej 1.406.19 €, të gjitha në vlerë të përgjithshme prej 1.874,92 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga dita e pranimit – dorëzimit të aktgjykimit, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. Nën II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës në vlerë prej 1.276,99 € e kërkuar me shumë se shuma e gjykuar. Nën III të dispozitivit është obliguar e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 259,20 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore
- Konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe

-Zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë të aprovon ankesën si të bazuar , ndërsa aktgjykimi i goditur të prishet dhe çështjen ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose ta ndryshoj dhe të refuzoj kërkesëpadinë në tërësi.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar .

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 si dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën prej 1.755,00 €, vlerën prej 50 %, të një page bazë për 10 vite të përvojës së punës, 75 % të një page bazë për 20 vjet të përvojës së punës, të vlerës së një page bazë për 30 vite të përvojës së punës dhe të vlerës prej 150 % të një page bazë për 40 vite të përvojës së punës si dhe në emër të pagës përcjellëse tri paga me rastin e pensionimit në lartësi prej tri pagave të mesatares së fundit duke llogaritur nga 468.00 €, e gjithsej shumën prej 1.395,00 € e në shumë të përgjithshme prej 3.150,00 €, si dhe ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marrë aktgjykimin më afër të përshkruar si më lartë, duke gjetur se nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura dhe nuk ka qenë gjithashtu kontestuese se paditësi ka përvojë pune prej 39 vite dhe se i njëjti është pensionuar me datë 22.06.2017 dhe lartësia e pagës që ka realizuar ka qenë 468.73 €. Përfundimisht gjykata e shkallës së parë ka përfunduar se paditësit i takojnë një pagë bazë në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 468,73 € dhe tri paga për përcjellje në pension në shumë prej 1.406,19 €, në shumë totale prej 1.874,92 €. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se këto paga i takojnë në kuptim dispozitave të neneve 35 par. 8, dhe pika 8.3 dhe par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, sa i përket pikës II të dispozitivit Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë në shumë prej 1.276,00 €, e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar ngase dispozita e nenit 35 par. 8 pika 8.3 parasheh se “ për 30 vjet përvojë të punës një vlerë të pagës bazë, ndërsa për 40 vite të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, e në rastin konkrete i njëjti ka 39 vite përvojë pune, çka do të thotë se për një vit nuk ka përmbushur kushtin për150 % të një page bazë. Gjykata e shkallës së parë vendimin sa i përket shpenzimeve si nën III të dispozitivit ka vendosur duke u bazuar në nenin dhe 452 të LPK-së.

Pranë gjendjes së këtyllë të çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësoi se aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m), në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare e as në ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 par2 pika n), kjo për faktin se dispozitivit është qartë dhe nuk është kontradiktor me vetveten dhe në të janë dhënë arsyet për faktet vendimtare për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Njëherit gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, duke vërtetuar drejtë se paditësit i takojnë tri paga për përcjellje në pension dhe një pagë bazë si shpërblim jubilar e në kuptim të neneve 35 par. 8, dhe pika 8.3 si

dhe par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për të gjitha faktet relevante për një vendim të drejtë e të ligjshëm, e të cilat arsye edhe kjo gjykatë i pranon në tërësi.

Përfundimisht gjykata vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore dhe gjeti se të njëjtat nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilën e ka marr gjykata e shkallës së parë.

Nga këto arsye të cekura si më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në kuptim të dispozitës së nenit 195, par.1 pika d) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1994/2020, të datës 12.01.2021**

**Kryetar i kolegjit – gjyqtari**

**Kujtim Pasuli**

Numri i lëndës: 2019:249565  
Datë: 19.01.2021  
Numri i dokumentit: 01419733